

# Informator për dispozicionin e mbeturinave 2018

**ZEBA** (Zweckverband der Zuger  
Einwohnergemeinden für die  
Bewirtschaftung von Abfällen)



## Bartja dhe grumbullimi, Ökihof

	Bartja	Ökihof	Ökibus (Cham, Zug)	Pikat e grumbullimit	Pikat e shitjes	Rösslitram (Baar)
Gjësede të mëdha, të djegshme	●	● <small>-50/kg të paktën</small>				
Letër (të lidhura)	●	●				
Karton	●	●				●



## Pikat e grumbullimit, Ökihof, Oekibus

Enë qelqi, për përdorim të njehershëm		●	●	●		●
Kanoçe llamarinë e hekurt		●	●	●		●
Alumin		●	●	●		●



## Ökihof, Pikat e shitjes

Shishe kthyese		●			●	●
PET-shishe pijesh		●	●		●	●
Shishe prej materialeve sintetike		●	●			●
EPS Polistirol shkumë montazhi		●	●			
Vajra të përdorura / Vajra gjelle		●				
Metal		●	●		●	
Qeramikë, porcelan, mbeturina ndertimesh		●	●			
Libra		●	●			
CD, DVD		●	●		●	●



## Ökihof, Pikat e shitjes

Bateritë, rimbushëse		●	●		●	●
Bateri makinash, Goma			1-/kg		●	
Kapsula të kafes		●			●	
Mjete ndriçimi neon		●	●		●	
Apartae elektrike dhe elektronike		●			●	
Aparate amvisërie, Frigorifer		●			●	



## Mbeturina të veçanta

Ilaçe		●			●	
Substanca kimike, bojëra dhe Ilaçe		●			●	

Pika e grumbullimit për elementet helmuese Zug, 041 728 17 00

**Kafshë të ngordhura:** KSG (deri në 70 kg edhe në Werkhof)

### Shumë të nderuara zonja dhë zotëri,

Në faqen e parë të informatorit mbi hedhjen e mbeturinave do të gjëni shënjat të cilat janë të shënuara edhe në gjësendet që keni për të hedhur. Vendet, emertimet dhe kohët e rëndësishme për hedhjen e mbeturinave janë të përkthyer. Në faqen katër ndodhen të dhënat e grumbullimit, ndërsa për komunat e mëdha mund të lexoni rregullat e grumbullimit për rrugët dhe zonat e grumbullimit.

Parimet e përgjithshme mbi grumbullimin dhe riciklimin e mbeturinave në Zvicërr mund ti gjëni të përkthyer në gjuhën tuaj amtare në internet apo te administrata e qytetit.

Këto informata ju mundësojnë që të sillni sa më shumë mbeturina për riciklim dhe kështu të kontriboni për ruajtjen e rezervave natyrore. Ju falënderit për kontributin tuaj.

### Ökihof

<b>Baar</b>	Altgasse 40   041 769 06 69 www.baar.ch
<b>Cham</b>	Furenmatt   041 723 87 90 www.cham.ch
<b>Hünenberg</b>	Zentrumstrasse 12   041 784 44 88 Zythus, Luzernerstrasse 91 www.huenenberg.ch
<b>Menzingen</b>	Industriestrasse 11   041 756 00 24 www.menzingen.ch
<b>Neuheim</b>	Beim Werkhof   041 755 35 92 www.neuheim.ch
<b>Oberägeri</b>	Wassermattli   079 455 89 03 www.oberaegeri.ch
<b>Risch</b>	Beim Sportpark   041 798 18 43 www.rischrotkreuz.ch
<b>Steinhausen</b>	Sennweidstrasse 2   041 748 11 33 www.steinhausen.ch
<b>Unterägeri</b>	Buchholzstrasse 17   041 750 32 30 www.unteraegeri.ch
<b>Walchwil</b>	Bahnhofstrasse 5   079 328 59 12 www.walchwil.ch
<b>Zug</b>	Äussere Güterstrasse   041 728 21 62 www.zug.ch

### Brockehuus

te Ökihof Zug, Tel. 041 725 26 90

Orari i punes

E merkurë: 13:00 – 16:30 / E shtunë: 09:00 – 13:00

### Çmimet

Thes me mbeturina amvisërie

17 litër Fr. 1.30

35 litër Fr. 2.50

60 litër Fr. 4.20

110 litër Fr. 7.60

Me pullë për mallra të përmasave të mëdha Fr. 16.40  
pro 20 kg, max. 1,5 x 0,5 x 0,5 m

Mbeturina të mdha për Kilogram Fr. 0.50

**Adresa të rënësishme** ZEBA, Selia Cham, Tel. 041 783 03 40, www.zebazug.ch

KSG, Kant. Sammelstelle der Gemeinden des Kt. Zug, Walterswil, Tel. 041 760 17 47

Pika e grumbullimit të helmeve Ökihof Zug, Tel. 041 728 17 00


# Rëndi shtëpiak Oekihof

Për të ju mundësuar komoditet të lartë, siguri dhe pastërti ne „Oekihof“, duhet tu përmbaheni udhëzimeve vijuese:

1. Duhet përmbajtur udhëzimeve të bashkëpunëtorëve të Oekihof
2. Kohëzgjatja e qëndrimit në Oekihof është e kufizuar në 15 minuta.
3. Gjatë orarit të punës lejohet hyrja për çdonjëri, leja e hyrjes mundë të kufizohet nga Komuna.
4. Fëmijëve të moshës nën gjashtë vjet hyrja u lejohet vetëm nën mbikëqyrje të prindërve ose të të autorizuarit për përkujdesje.
5. Qenët duhet mbajtur në litar ose lidhur jashtë ambientit.
6. Taksat duhet paguar me para të gatshme. Duhet marrë dëshmia e pagesës.
7. Taksat llogariten për kg. Vlen minimumi i taksës prej 2,- CHF. TVSH-ja është në çmim.
8. Mallrat e dorëzuara kalojnë në pronësi të ZEBA ose organizatës përkatëse të vlerësimit. Këto mallra nuk guxojnë të merren me vete nga vizitorët e Oekihof.
9. Për tregtarët më mallra të përdorura ose tregtarët e auksioneve Oekihof nuk është vend furnizimi me material.
10. Për marrjen pa pagesë të materialeve për këndin e këmbimit vendosë drejtoria e Oekihof. Në raste dyshimi detyrohet taksa e vlerësuar si referuese.
11. Deponimi i mbeturinave ose materialit për dorëzim para Oekihof është i ndaluar.
12. Në Oekihof nuk mund të sillen eksplozivi, municioni dhe armët. Mirëpo ato mund të dorëzohen në secilën zyre të policisë.
13. Mbeturinat me shenjën e rrezikut ngjyrë portokalli duhet të merren pa shpenzime edhe nga farmacitë dhe drogeritë.
14. Banuesit e kantonit Zug mundë të përdorin secilin Oekihof të komunave të Zug-ut.

Shkeljet e kësaj rregulloreje mundë të kenë për pasoj përjashtimin, ndalesën e hyrjes, ndjekjen penale dhe kërkesat për kompensim, Ju falëm nderit për mirëkuptim.

**Zweckverband der Zuger Einwohnergemeinden für die Bewirtschaftung von Abfällen (ZEBA)**



Për sigurinë tuaj, areali ka mbikëqyrje me video.

# Mbeturinat – ku duhet t'i çojmë ato?



Recycling Zug parashikon që në saje të një tarife përpunimi të paguar paraprakisht të bëhet i mundur dorëzimi pa pagesë i shumicës së mbeturinave në pikat ekologjike (Oekihof) të çdo komune. Çmimet për mbeturina të tilla, për të cilat duhet paguar tarifë, si plehra shtëpie (bërlllog) që duhen djegur, bateritë e automjeteve dhe gomat, mund t'i gjeni në Fletën Udhëzuese për mbeturinat të komunës suaj.

## Tre mënyra për reduktimin e mbeturinave:

### Mënjanimi

Mendohuni mirë përpara se të blini diçka: a keni nevojë me të vërtetë për të? Hiqni dorë me ndërgegje nga sendet e tepërta. Zgjidhni produkte që rrojnë gjatë dhe që janë të pranueshme ekologjikisht. Refuzoni paketimet e tepërta.

### Reduktimi

Blini produkte që mund të riparohen. Preferoni shishet dhe enët që mund të përdoren përsëri. Mënjaroni krijimin e mbeturinave. Blini gjithmonë vetëm atë sasi që u nevojitet patjetër.

### Përpunimi

Zgjidhni materiale që mund të përpunohen përsëri, si letër, qelq, metal. Përdorni disa herë si në shtëpi ashtu edhe në punë të njëjtin paketim. Nëqoftëse blini produkte që mund të përpunohen përsëri (Recycling), mbyllet cikli i lëndëve të para. Mbeturinat e kuzhinës ose të kopshtit mund të kompostohen në ballkon ose në kopsht ose t'i jepen atij që quhet Cikli i Gjelbër (Grüntour).

### Keni pyetje të tjera?

Po të keni pyetje të tjera, drejtoju Zyrës përkatëse për Mbrojtjen e Ambjentit në komunën tuaj. Edhe personeli i shërbimit në pikat ekologjike mund t'ju ndihmojë me siguri për të zgjidhur problemet tuaja.

### Ndani mbeturinat!

Lëndët e mëposhtme nuk duhet të hidhen në thesin e plehrave:

### Mbeturinat e gjelbëra:

Nëpërmjet kompostimit të mbeturinave të kuzhinës dhe të kopshtit krijohet një humus i mrekullueshëm. Prandaj mbeturinat e gjelbëra nuk mund të çohen në pikat ekologjike, por merren nga i ashtuquajtur i Cikli i Gjelbër.

### Qelqi i vjetër:

Kthejini enët dhe shishet prej qelqi që mund të përdoren përsëri në shitore. Hidhni xhamërat e thyera dhe ato të pathyera (shishet Chianti së bashku me shportën) veçmas dhe të ndara sipas ngjyrës në kontenerët përkatës të qelqit. Nga qelqi

i vjetër i mbledhur mund të prodhohen shishe të reja.

### Metalet e vjetra:

Çojini metalet e vjetra në pikën ekologjike të komunës suaj. Konservat prej teneqeje të bardhë dhe alumini grumbullohen ndarazi. Metalet e vjetra mblidhen, shkrihen dhe shfrytëzohen përsëri.

### Gomat:

Kthejini gomat e vjetra në garazh ose në vendet e shitjes, ku i keni blerë këto ose gomat e reja. Ato vishen me një shtresë të re gome ose përdoren si lëndë djegëse në fabrikat e çimentos.

### Tekstilet:

Dorëzoni rrobat që janë të mbajtura mirë dhe të pastra grupeve bamirëse që organizojnë grumbullimin e tyre. Thasët plastikë që përdoren në këtë rast ju dërgohen me postë sa herë që të keni nevojë.

### Vajrat e vjetra:

Si në rastin e vajrave minerale ashtu edhe të atyre bimore (vajra motorike ose vajra ushqimore) bëhet fjalë për mbeturina të një lloji të veçantë. Në çdo rast çojini vajin veçmas te mekaniku ose në pikën ekologjike. Mos e derdhni atë kurrë në ujërat e zeza (si lavabo, lavaman, kanalizime).

### Aparatet elektrike:

Televizorët e prishur, kompjuterët, radiot, frizhiderët etj. duhet t'i rikthehen furnizuesit ose një shitoreje që shet aparate të reja ose të dorëzohen në pikën ekologjike. Shitoret duhet t'i marrin këto aparatura pa pagesë.

### Llambat e neonit:

Kthejini llambat me neon dhe llambat që kursejnë energji në dyqanin ku i keni blerë ose në pikën ekologjike. Lëndët përbërëse të tyre depozitohen në mënyrë profesionale, metali dhe qelqi përpunohen përsëri.

### Prodhimet kimike:

Grumbullojini ngjyrat, llaket, medikamentet, produktet helmuese dhe kimike duke i ndarë njëri nga tjetri dhe çojini ato në drogerinë ose farmacinë tuaj.

### Bateritë dhe bateritë e automjeteve:

Kthejini ato në vendet e shitjes, garazhet, respektivisht në pikën ekologjike. Ato bëhen përsëri të përdorshme.